



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 80/2012
Prishtinë, më 23.10.2012, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C–203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Berat Buzhala dhe Visar Ymeri.

Pjesëmarrës të ftuar: Igballe Rexhaj – Jashari, Ibush Luzha, Ruzhdi Shehu dhe Visar Bajraktari – Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Ukë Gashi –ZPRK; Dardan Abazi – INDEP; Florije Mehmeti – KDI dhe Erëza Pula – GLPS.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti – kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.10.2012;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L–162 për investimet e huaja;
4. Debat në lidhje me zbatimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit (cilësia e karburanteve të lëngëta të naftës);Të ftuar për raportim, zyrtarët e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Propozoi që pika e katërt (4) e rendit të ditës, të kalojë si pikë e tretë e rendit të ditës, për arsye të debatit të gjatë që mund të zhvillohet dhe prezencës së përfaqësuesve nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Me propozimin e kryetarit u pajtuan anëtarët e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimin e propozuar në renditje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.10.2012

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 17.10. 2012 u miratua pa vërejtje.

3. Debat në lidhje me zbatimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit (cilësia e karburanteve të lëngëta të naftës)

Kryetari– Tha se në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni ka ftuar zyrtarët përkatës të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – MTI, për të njoftuar më në detaje në lidhje me zbatimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Pastaj, fjalën ia dha përfaqësuesit nga MTI– ja, z. Ibush Luzha.

Ibush Luzha (drejtori i Departamentit për Akreditim në kuadër të MTI–së) – Paraqiti një ekspozë në mënyre kronologjike të legjislacionit, lidhur me procedurat e zbatimit të Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit. Duke u bazuar në udhëzimet administrative për autorizimin e trupave për vlerësimin e konformitetit dhe në Udhëzimin Administrativ për cilësinë e karburanteve të lëngut të naftës, njoftoi Komisionin lidhur edhe me shkresën e kompanisë KPU–Inspekt, që i është drejtuar edhe Komisionit parlamentar, që në bazë të këtyre udhëzimeve të lartcekura, është marrë vendimi i refuzimit të kërkesës për marrje të autorizimit si trup inspektues për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës. Arsyeja e refuzimit ka qenë mosplotësimi i kërkesave të parapara me ligj dhe udhëzimet administrative.

Kryetari – Pyeti lidhur me cilësinë e naftës dhe rreth shkresës së kompanisë KPU Inspekt: Cili është problemi për mosvazhdimin e licencës si trup inspektues?

Ibush Luzha (drejtori i Departamentit për Akreditim në kuadër të MTI–së) – Cilësia është kuptim i gjerë dhe për të qenë naftë cilësore, duhet të plotësohen disa kriterë. Legjislacioni i rregullon këto kriterë edhe me udhëzime administrative. Sa përket kompanisë KPU Inspekt, ka qenë duke e kryer punën inspektuese të cilësisë së naftës, por pastaj nuk ka aplikuar në konkursin e hapur publik, sepse nuk e ka pasur të kompletuar dokumentacionin sipas shpalljes publike.

Teuta Sahatqija – Pyeti: Pasi që i ka kaluar afati kompanisë KPU Inspekt, a është shpallur konkursi dhe sa është numri i trupave inspektuese për kontrollimin e cilësisë së naftës?

Ibush Luzha (drejtori i Departamentit për Akreditim në kuadër të MTI–së) – Tha se konkursi është shpallur për trupa inspektuese, pasi që kompanisë KPU Inspekt i ka skaduar afati i kontratës, dhe numri i trupave inspektues që nga viti 2006 është pesë, ndërsa tani janë të akredituar vetëm dy.

Lutfi Zharku – Pyeti: Cila është baza ligjore apo ligjshmëria e funksionimit të trupave inspektuese dhe konflikti i interesit të kësaj kompanie?

Ibush Luzha (drejtori i Departamentit për Akreditim në kuadër të MTI-së) – Tha se inspektorati bën matjen me shikim, në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2012, ndërsa detyra e trupave inspektuese është që t'i dërgojë mostrat e naftës në laborator për testimin vlerësues të naftës. Po, është e vërtetë që në Komisionin për hartimin e Udhëzimit Administrativ ka marrë pjesë përfaqësuesja e kompanisë KUP Inspekt. Në bazë të Ligjit është gjetur që ka pasur konflikt të interesit, prandaj është larguar për shkak të konfliktit të interesit.

Lutfi Zharku – Tha se në bazë të Ligjit, trupa inspektuese është për të dalë në inspektim, sepse këtë e kanë për detyrë, ndërsa Udhëzimi Administrativ është në kundërshtim me Ligjin dhe nuk mund të jetë trup inspektues vetëm vlerësues.

Myzjane Selmani – Theksoi se udhëzimet administrative nuk e kanë fuqinë e Ligjit, andaj duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe trupa inspektuese duhet që në radhe të parë t'i përmbahet ligjit, propozoi që Udhëzimi Administrativ të rishikohet dhe të hartohet në pajtim me Ligjin.

Hashim Deshishku – Pyeti: Trupa inspektuese a del në terren për të inspektuar për dokumentacionin që është i paraparë me ligj dhe a është duke punuar MTI-ja që të lejohet nafta për nevojat e ngrohjes?

Ruzhdi Shehu (Inspektorati i MTI-së) – Tha se trupa inspektuese e bën kontrollimin e dokumentacionit përcjellës dhe analizohet i gjithë dokumentacioni në bazë të Udhëzimit Administrativ. Kjo është një procedurë e gjatë, por trupat inspektuese i marrin mostrat, pastaj i dërgojnë në laborator për testim të vlerës së cilësisë. Tha se, sa i përket cilësisë së naftës, është testuar në bazë të rregullores, duke përcaktuar se cilat duhet të jenë kriteret dhe standardet e cilësisë së naftës, ku është e rregulluar edhe leja për kompanitë që e bëjnë transportimin e derivateve të naftës, ndërsa pjesa tjetër e procedurave është edhe vlerësimi i analizave testuese. Në shumicën e rasteve apo prej 500 testimeve, vetëm 37 testime nuk e kanë pasur cilësinë dhe kriteret e parapara me Ligjin për derivatet e naftës.

Visar Bajraktari (zyrtar nga MTI-ja) – Tha se sa i përket lejimit të naftës të ngrohjes, arsyeja e moslejimit deri më tani është se duhet të ndryshohet Udhëzimi Administrativ, por që kjo ka një akcizë që e rrit çmimin e blerjes.

Sala Berisha Shala – Në bazë të 500 testimeve që janë bërë për cilësinë e naftës, vetëm 37 prej tyre kanë dalë që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara me rregullore. Po shihet që deri diku janë duke u zbatuar kriteret e parapara me ligj. Prandaj, i mbetet MTI-së dhe organeve kompetente që të punojnë më shumë në këtë drejtim.

Pas debatit, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Debati të shqyrtohet në takimet e radhës së Komisionit me ministren e Tregtisë dhe Industrisë.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-162 për investimet e huaja

Kryetari – Lidhur me këtë Projektligj të proceduar nga Qeveria, hapi debat dhe propozoi që të formohet një grup i punës. Sipas Rregullores së Kuvendit, ky grup i punës duhet ta shqyrtojë

Projektligjin dhe, pastaj, t'i nxjerrë propozim–amendamentet për shqyrtim në mbledhje të Komisionit.

Pas debatit, Komisioni unanimitasht nxori këtë

P ë r f u n d i m

Miratohet në parim Projektligji nr. 04/L–162 për investimet e huaja.

Komisioni vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligj nr. 04/L–162 për zonat ekonomike.

Po ashtu, Komisioni unanimitasht nxori këtë

V E N D I M

1. Formohet grupi i punës për shqyrtimin e Projektligji nr. 04/L–162 për investimet e huaja.
2. Grupi i punës ka këtë përbërje: Myzejene Selmani raportuese, Teuta Sahatqija dhe Lutfi Zharku, anëtarë.
3. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij.
4. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.
5. Të ndryshme
Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit